



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TROPOJE

KESHILLI BASHKIAK

Nr. 2774 Prot

B. Curri, me 4 . 7 . 2022

V E N D I M

Nr 44 Dt . 30.06. 2022

PËR

MIRATIMIN E KËRKESËS SË BASHKISË TROPOJË, SË BASHKU ME DOKUMENTACIONIN TEKNIKO LIGJOR PËR AKORDIMIN E NDIHMËS FINANCIARE PËR RIKONSTRUKSION (BLERJE MATERIALESH) URA KOJEL - SHUMICE, NJESIA ADMINISTRATIVE TROPOJE, BASHKIA TROPOJE DEMTURA ME DATË 15. 03.2022

Këshilli i Bashkisë Tropojë, në mbledhjen e tij të datës 30.06. 2022, në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1/1.1, shkronja "b", nenit 34 pika 6, Ligjit Nr.139/2015 "Per Vetqeverisjen Vendore"; Nr. 44/2015, datë 30.04.2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; Ligjit nr. 45/2019, "Per Mbrojtjen Civile", Kreu I pika 1; Kreu III, neni 27 Shkronja "c", Neni 29 pika 2, Neni 30 shkronja "f"; Kreu IV Neni 40 Shkronja "a"; Kreu XI Neni 65 pika 1; Te VKM-së nr. 329, datë 16.05.2012 pika 3, shkronja "gj" dhe "h", "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmëve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore"; Vendimi nr.414 datë 8.7.2021 "Per miratimin e Procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile"

V E N D O S I :

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Tropojë për përgaditjen e dokumentacionit për rikonstruksionin e Ures **KOJEL – SHUMICE**, Njësia Administrative Tropojë të dëmtuar nga reshjet e shumta të datës 15. 03 . 2022

2. Ti akordojë fondin prej 1 838 452 ( njëmiljon e tetëqind e tridhjetë tetëmije e katerqind e pesdhjet e dy ) Blerje materialesh për riparimin e kësaj ure të dëmtuar nga reshjet e shumta të datës 15.03.2022.



3. Burimi i financimit është Fondi Emergjences Civile të parashikuar në buxhetin e Bashkisë Tropojë për vitin 2022 miratuar me VKB , Nr.111 datë 24.12.2021, "Për miratimin e buxhetit dhe numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë Tropojë për vitin 2022."

4. Të miratojë dokumentacionin tekniko- ligjor të hartuar nga Bashkia Tropojë

5. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohen Sektori i Emergjencave Civile, Drejtoria Ekonomike, Sektori i Finances.

6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**Sekretar**  
**Ergent Gjongecaj**



**Për Këshillin Bashkiak Tropojë**

**Kryetar**  
**Shotë Bashaj**



Shpallur me 04.07.2022  
Miratuar me 15 vota  
Vota Pro 15 vota  
Vota Kunder 0 vota  
Vota Abstenim 0 vota